

Vendim nr. 231 datë 16.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 16.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (T) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: TOM DEDAJ, përfaqësuar me prokurë nga avokat Gëzim Ceka.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1059, datë 18.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Shfuqizimi i nenit 300 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë i titulluar “Moskallëzimi i krimit”.
Shfuqizimi i nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale i titulluar “Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 31, 32, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 8 dhe 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Tom Dedaj ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

2. Pas shfaqjes së një regjistrimi filmik gjatë një emisioni në një televizion kombëtar, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka filluar procedimin penal dhe në përfundim ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të kërkuesit dhe të shtetasit F.Z., për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal (KP).

3. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (*gjykata e shkallës së parë*), me vendimin nr. 88, datë 26.07.2018, mes të tjerave, ka vendosur për kërkuesin deklarinim fajtor për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i KP-së dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 59 të KP-së është vendosur pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia e kërkuesit në provë për një periudhë 5-vjeçare me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. Po kështu, në aplikim të neneve 30, pika 1, 35, 44 paragrafi 2, të KP-së, është vendosur dhënia e dënimit plotësues, heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike për 5 vjet. Në mënyrë të përmbledhur, gjykata e shkallës së parë, bazuar në dëshminë e disa personave dhe provave materiale e dokumentare, ka arsyetuar se kërkuesi ka përfituar në mënyrë të parregullt një shumë të hollash, në këmbim të veprimit që ka lidhje me funksionin e tij si prokuror (*shih faqet 22 e në vijim të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*). Ndërsa për sa u takon kërkesave paraprake të paraqitura nga kërkuesi për pavlefshmërinë dhe papërdorshmërinë e pothuajse të gjitha akteve të hetimit paraprak, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e tyre.

4. Pas ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda (*gjykata e apelit*), me vendimin nr. 89, datë 06.11.2018, ka vendosur ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe deklarinim e kërkuesit fajtor për kryerjen e veprës penale “Moskallëzimi i krimi”, të parashikuar nga neni 300 i KP-së dhe dënimin e tij me 1 vit burgim. Në aplikim të nenit 59 të KP-së është vendosur pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia e kërkuesit në periudhë prove për 2 vjet, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. Po kështu, në aplikim të neneve 30, pika 1, 35 dhe 44, paragrafi 2, të KP-së është vendosur dhënia e dënimit plotësues, heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike për 1 vit.

Gjykata e apelit ka arsyetuar se nuk ka gjetur prova të mjaftueshme që të provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerjen e veprën penale, të parashikuar në nenin 319/ç të KP-së, por me veprimet e kërkuesit është provuar të ketë kryer veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar në nenin 300 të KP-së (*shih faqen 20 të vendimit të gjykatës së apelit*). Ndërkohë gjykata e apelit ka gjetur të bazuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e kërkesave paraprahe.

5. Ndaj vendimit të lartpërmendur ka ushtruar rekurs në datën 14.11.2018 kërkuesi dhe në datën 14.12.2018 Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Në datën 21.12.2018 kërkuesi ka paraqitur rekurs (shtesë) dhe në datën 05.03.2024 ka paraqitur përsëri rekurs (shtesë).

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1059, datë 18.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura si nga prokuroria dhe kërkuesi, pasi nuk përmbanin asnjë prej shkaqeve që parashikohen në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

7. Në datën 17.07.2024 kërkuesi (*data e shërbimit postar*) i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 00-2024-1059, datë 18.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Kërkuesi ka paraqitur edhe dy kërkesa të tjera shtesë, respektivisht në datat 23.08.2024 dhe 01.10.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

8.1. Cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

8.1.1. *Së drejtës për t'u njoftuar*, pasi atij dhe mbrojtësit të tij nuk i është njoftuar rekursi i prokurorisë dhe data e seancës, megjithëse Gjykata e Lartë dispononte të dhënat e adresës elektronike.

8.1.2. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur*, pasi vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duhej të merrej në seancë gjyqësore në praninë e palëve. Gjykimi i çështjes nga kjo gjykatë është bërë në mungesë të kërkuesit dhe mbrojtësit të tij, duke i cenuar në këtë mënyrë të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur.

8.1.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, ndërkohë që duhej të shqyrtohej në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Gjykata e

Lartë nuk ka ushtruar funksionin e saj si gjykatë e ligjit, por ka bërë vlerësimin e provave.

- 8.1.4. *Së drejtës së aksesit substancial*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Në sekretarinë e Gjykatës së Lartë është depozituar një akt i titulluar shtesë rekursi dhe nuk është depozituar kundërrekursi sikundër shprehet në vendim Gjykata e Lartë. Emërtimi kundërrekursi është bërë nga Gjykata e Lartë me qëllim rrëzimin e aktit.
- 8.1.5. *Parimit të paanësisë*, pasi gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë nga kërkuesi dhe i pandehuri F.Z., është kërkuar përjashtimi i trupit gjykues dhe kërkesa nuk është pranuar.
- 8.1.6. *Parimit të mosdiskriminimit*, pasi nëse do të ishte proceduar që në fillim për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, do të vijonte të qëndronte në detyrë deri në një vendim të formës së prerë. Gjithashtu, ky parim është cenuar, pasi në media është përmendur dhe biseda si person i korruptuar.
- 8.1.7. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi është paragjykuar dhe dënuar, duke u bazuar në publikimin e një ngjarjeje në një televizion publik. Edhe pas mendimit të ekspertëve se nuk mund të përcaktohen emrat e personave që janë në video, prokuroria ka vijuar me akuzën për korrupsion. Gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë vendosur deklarinimin fajtor duke u bazuar në fakte të rreme, pa i verifikuar ato. Kallëzimi penal i kërkuesit ndaj shtetasit F.Z. nuk është i datës 19.10.2016, sikundër shprehen gjykatat, por është dorëzuar në datën 20.10.2016 dhe gjykata e apelit nuk ka verifikuar nëse kallëzimi ishte bërë nga kërkuesi si qytetar ose si nëpunës publik. Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh dëshminë, sipas së cilës shtetasi F.Z. ka probleme me shëndetin mendor.
- 8.1.8. *Ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së formimit dhe njoftimit të akuzës*, pasi nga prokuroria nuk është njoftuar asnjëra nga akuzat dhe kjo është trajtuar me hollësi në aktet e ankimet e paraqitura përpara të gjitha gjykatave. Nëse do të ishte komunikuar akuza e re do të ishte kërkuar gjykimi i shkurtuar duke përfutur ulje dënimi. Gjykata e apelit nuk ka përmendur nenin 375 të KPP-së dhe ka bërë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale. Mënyra si është formuluar neni 375 i KPP-së i ka mohuar të pandehurit të drejtat elementare, si njohja me materialet e çështjes, duke cenuar parime si barazia e armëve dhe

kontradiktoritetit, e drejta për të thirrur e pyetur dëshmitare dhe ekspertë, e drejta për të kundërshtuar provat e paraqitura dhe për të mos bërë deklaratime.

8.1.9. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë e ka trajtuar rekursin shtesë të paraqitur nga kërkuesi si kundërrekurs, duke vendosur mospranimin. Gjykata e Lartë është kontradiktore për datën e formimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), pasi prokurori i çështjes është zgjedhur anëtar dhe rekursi nuk duhej të pranohej, sepse nuk ishte bërë nga prokurori i çështjes. Si kërkuesi dhe prokuroria kanë parashtruar të njëjta shkaqe që parashikohen nga neni 432 i KPP-së. Kërkuesi i ka bashkëlidhur rekursit disa vendime që Gjykata e Lartë as nuk i ka përmendur. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, por shprehet se gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit të parashtruara në recurs. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë për pretendimin se rekursi nuk ishte bërë nga prokurori i çështjes nuk është i qartë. Gjykata e Lartë nuk ka trajtuar në vendim të gjitha pretendimet e ngritura për pavlefshmërinë e akteve të hetimit, sikurse ka qenë edhe procesverbali për njohjen e akteve, të cilin kërkuesi nuk e ka nënshkruar, sepse nuk ka qenë prezent, ndërsa në procesverbal oficeri i Policisë Gjyqësore shprehet “refuzoi firmën”. Gjykata e Lartë ka shkelur ligjin kur shprehet se vendimi i gjykatës së apelit është i bazuar në ligj e në prova.

8.2. Shfuqizimin e nenit 300 të KP-së që parashikon veprën penale “Moskallëzimi i krimi”, pasi bie në kundërshtim me moralin dhe zakonet e mira të shqiptarit, por edhe me KEDNJ-në.

8.3. Shfuqizimin e nenit 375 të KPP-së, që parashikon ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata, pasi cenon të drejtat e të pandehurit. Në rastin e kërkuesit, që ka ushtruar detyrën e prokurorit, nëse do të ishte akuzuar prej fillimit për veprën penale “Moskallëzimi i krimi” nuk do të ishte pezulluar nga detyra, pasi për prokurorin vendoset pezullimi nga detyra kur ndaj tij ka procedim penal për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon një dënim jo më të ulët se 5 vjet burgim. Gjykata duhet të njoftojë të pandehurin dhe prokurorin me qëllim paraqitjen e konkluzioneve të tyre në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale.

8.4. Verifikimin e ligjit për amnistinë, pasi është ndryshuar tre herë nga viti 2016 deri në vitin 2024. Pas dënimit nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, kërkuesi ishte subjekt që përfitonte nga ligji për amnistinë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi me anë ankimit kushtetues individual ka kërkuar: (i) shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin gjyqësor ndaj tij; (ii) shfuqizimin e neneve 300 të KP-së dhe 375 të KPP-së të zbatuara gjatë procesit gjyqësor.

10. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se kërkuesi legjitimohet nëse plotëson bashkërisht këto kriteret: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm, që do të thotë se për zbatimin e tij nuk është i nevojshëm miratimi i akteve nënligjore; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materiae*) (shih vendimet nr. 4, datë 21.01.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Në zbatim të këtyre standardeve, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës,

sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor penal në të cilin është dhënë vendimi objekt kundërshtimi në Gjykatë, gjatë të cilit (procesit) janë zbatuar edhe nenet 300 të KP-së dhe 375 të KPP-së. Gjithashtu, Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ngre pretendime edhe në lidhje me ligjin e amnistisë, i cili nuk rezulton që të jetë zbatuar ndaj kërkuesit. Për rrjedhojë, ai nuk legjitimohet *ratione personae* në lidhje me këtë pretendim, pasi nuk ka provuar lidhjen e drejtpërdrejtë me ligjin e kundërshtuar, në kuptim të neneve 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

13. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga individi përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive* në dispozicion. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t'i drejtohet Gjykatës.

14. Qëllimi i këtij kriteri është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ajo pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 24, datë 11.10.2022; nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Ndërsa në lidhje me ankimin kushtetues individual, me objekt kundërshtimin si antikushtetues të ligjit, Gjykata ka theksuar se kërkuesi duhet t'i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese që cenon ligji i kundërshtuar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individi duhet, së pari, t'i kundërshtojë ato përpara gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike efektive që parashikon sistemi ynë juridik. Meqenëse mjete juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i paanësisë, pasi ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit, por nuk është pranuar. Në lidhje me këtë pretendim, nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të administruar për qëllim të shqyrtimit të çështjes, rezulton se gjatë gjykimit në shkallë të parë i pandehuri tjetër F.Z. ka paraqitur kërkesa për përjashtimin e trupit gjykues. Me vendimin nr. 103, datë 21.04.2024, gjykata e shkallës së parë ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur kërkesë për përjashtimin e një gjyqtari ose të trupit gjykues, si dhe këtë pretendim nuk e parashtuar në ankim ose rekurs. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për pretendimin e cenimit të parimit të paanësisë ai nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij.

17. Në lidhje me pretendimet e tjera të parashtuara në ankimin kushtetues individual në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë, kërkuesi e plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit, duke parashtuar pretendimet e tij. Gjithashtu, edhe për antikushtetutshmërinë e neneve 300 të KP-së dhe 375 të KPP-së, Kolegji vlerëson se kërkuesi e përmbush kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi i vetmi mjet në dispozicion për rivendosjen në vend të të drejtave është ankimi kushtetues individual.

18. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Po kështu, neni 50, pika 4, i po këtij ligji parashikon se individët mund të paraqesin kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën, ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Pra, në rastin e ankimit kushtetues individual, konstatimi i cenimit, si rregull, nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ, por afati ligjor llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuesin ose, e thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ.

19. Në rastin konkret, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor ku janë zbatuar nenet e kundërshtuara, mban datën 18.04.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 17.07.2024 (*data e shërbimit postar*), për rrjedhojë kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është brenda afatit ligjor 4-mujor.

20. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, në mënyrë të përmbledhur, kërkuesi ka pretenduar se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të: i) së drejtës

për t'u njoftuar; ii) për t'u dëgjuar dhe mbrojtur; iii) gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj; iv) aksesit substancial; v) parimit të mosdiskriminimit; vi) prezumimit të pafajësisë; vii) standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e nenit 300 të KP-së "Moskallëzimi i krimin", si dhe shfuqizimin e nenit 375 të KPP-së. Gjithashtu, kërkuesi në kërkesën e datës 23.08.2024 ka paraqitur pretendime për cenimin e ligjshmërisë e bazueshmërisë së formimit dhe njoftimit të akuzës, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, së drejtës për të thirrur e pyetur dëshmitarë dhe ekspertë, për të kundërshtuar provat e paraqitura dhe për të mos bërë deklaratime. Sipas tij, nëse do të ishte komunikuar akuza e re, sipas ndryshimeve të bëra nga gjykata e apelit, do të kishte kërkuar gjykimin e shkurtuar duke përfutur uljen e dënimit dhe se mënyra si është formuluar neni 375 i KPP-së i ka mohuar të pandehurit të drejta elementare, si njohja me materialet e çështjes.

21. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u njoftuar kërkuesi ka parashtruar se: (i) nuk është njoftuar rekursi i prokurorit; (ii) nuk është njoftuar data e seancës; (iii) gjykimi i çështjes nga Gjykata e Lartë duhej të bëhej në seancën gjyqësore në praninë e palëve dhe jo në dhomën e këshillimit, duke u cenuar, sipas tij, edhe e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.

22. Për kërkimin e parë, pra për pretendimin se nuk i është njoftuar rekursi i prokurorit, nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të administruar për shqyrtimin e çështjes konstatohet se në datën 14.12.2018 rekursi i prokurorisë i është njoftuar kërkuesit, sipas dëftesës së komunikimit të nënshkruar nga vetë ai, si dhe avokates J.K., sipas dëftesës së komunikimit të nënshkruar prej saj në datën 09.01.2019. Në vijim, kërkuesi në datën 21.12.2018 ka paraqitur shtesë rekursi. Për më tepër, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga prokurori. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se për këtë pretendim kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë argument se si vendimi i mospranimin të rekursit të prokurorit i ka cenuar të drejtat e tij kushtetuese, prandaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

23. Për sa i takon pretendimit të kërkuesit se gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë duhej të bëhej me praninë e palëve, pasi zhvillimi i saj në mungesë të tij dhe mbrojtësit i ka cenuar të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur nga një gjykatë e caktuar me ligj, Kolegji thekson se, në rastin konkret, rekursi e ushtruara nga kërkuesi dhe prokuroria janë shqyrtuar gjatë veprimtarisë seleksionuese të dhomës së këshillimit në Gjykatën e Lartë, e cila, sipas jurisprudencës së Gjykatës, është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Prandaj kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraparak

vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 26, datë 27.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Kolegji konstaton se neni 437 i KPP-së parashikon rastet kur Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, pra kur çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës, për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore ose kur vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Penal thirrja dhe dëgjimi i palëve, për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes në rastet e përcaktuara në nenin 432, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, të KPP-së.

24. Bazuar për sa më sipër, Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka parashtruar argumente nëse çështja e tij hynte në një nga rastet e parashikuara nga neni 437 i KPP-së, prandaj pretendimi për cenimin e së drejtës së për t’u njoftuar dhe asaj për t’u dëgjuar së bashku me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, nuk mund të merret në shqyrtim.

25. Për pretendimin e cenimit të parimit të mosdiskriminimit, kërkuesi ka pretenduar se nëse do të ishte proceduar prej fillimit për veprën penale “Moskallëzimi i krimi”, do të vijonte të qëndronte në detyrë deri në një vendim të formës së prerë. Gjithashtu, ky parim është cenuar, pasi ai është përmendur në media si person i korruptuar.

26. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Roli i Gjykatës nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që ushtron Gjykata nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të mosdiskriminimit për shkak të kualifikimit të veprës penale lidhet me zbatimin e ligjit, ndërsa argumentet se është përmendur në media, si një person i korruptuar, nuk janë argumente kushtetuese në mbështetje të pretendimit të tij, për rrjedhojë nuk mund të merret në shqyrtim.

28. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, kërkuesi ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se edhe pas mendimit të ekspertëve se nuk mund të përcaktoheshin emrat e personave që ishin në video, prokuroria ka vijuar me akuzën për korrupsion. Gjykatat kanë vendosur deklarimin fajtor, duke u bazuar në fakte të rreme, pa i verifikuar ato, nuk kanë

verifikuar nëse kallëzimi ishte bërë nga kërkuesi si qytetar ose si nëpunës publik, si dhe nuk është marrë parasysh dëshmia, sipas së cilës shtetasi F.Z. ka probleme të shëndetit mendor.

29. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit çmuarja e provave, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, si dhe të çmuarjes së provave për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 45, datë 23.07.2012; nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në këndvështrim të standardeve kushtetuese, Kolegji vlerëson se argumentet e kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë kanë të bëjnë me vlerësimin e provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë nuk hyjnë në sferën e juridiksionit kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim. Për më tepër, Kolegji vëren se gjykatat e faktit nuk e kanë nisur procesin me paragjykimin se kërkuesi ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, por kanë analizuar një sërë provash, si, dëshmitë e dëshmitarëve, akte shkresore, prova materiale dhe ekspertimi teknikokompjuterik.

31. Kolegji vëren se kërkuesi ka kërkuar edhe shfuqizimin e nenit 300 të KP-së, i cili parashikon veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, pasi është në kundërshtim me moralin, zakonet e mira dhe me dispozitat e KEDNJ-së. Sipas kërkuesit, nëse do të ishte akuzuar prej fillimit për këtë veprë penale, nuk do të ishte pezulluar nga detyra e prokurorit. Gjithashtu, sipas kërkuesit, duhet të shfuqizohet edhe neni 375 i KPP-së, që parashikon ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata, pasi cenon të drejtat e të pandehurit. Kolegji konstaton se edhe pretendimet shtesë të paraqitura në datën 23.08.2024 në thelb lidhen me pretendimin për shfuqizimin e nenit 375 të KPP-së, pasi ai ka parashtruar se duke mos iu komunikuar akuza e re, pas ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, janë cenuar të drejta dhe parime kushtetuese në drejtim të së drejtës për të kundërshtuar akuzën, për të paraqitur prova, për të pyetur dëshmitarë.

32. Nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkuesit, Kolegji vlerëson se ai nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues për të provuar se këto norma juridike kanë sjellë pasoja në drejtim të të drejtave të tij kushtetuese. Për më tepër, argumentet për shfuqizimin e nenit 375 të KPP-së në thelb janë të njëjta me ato të parashtruara për pretendimin për cenimin e parimit të mosdiskriminimit, të cilat, sikurse u analizuan, lidhen me vlerësimin e provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të jenë pjesë e kontrollit kushtetues.

33. Në vijim të sa më lart, Kolegji do të analizojë pretendimet e tjera të kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur për shkak të mosnjoftimit të datës së seancës në Gjykatën e Lartë, si dhe të aksesit substancial e standardit të arsytimit të vendimit, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues. Argumentet për cenimin e së drejtës së aksesit substancial dhe të standardit të arsytimit të vendimit lidhen me qëndrimin/përmbajtjen e vendimit të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë Kolegji do t'i shqyrtojë së bashku.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur

34. Kërkuesi ka pretenduar se nuk i është njoftuar data e seancës, megjithëse Gjykata e Lartë kishte të dhënat e adresës së postës elektronike.

35. Jurisprudenca e Gjykatës ka pranuar si elemente përbërëse të procesit të rregullt ligjor edhe të drejtën për t'u dëgjuar. Kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 7, datë 12.03.2010; nr.12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në çështjen konkrete, Kolegji konstaton se në datën 09.02.2024 është bërë njoftimi me shpallje për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit në datën 19.03.2024, duke njoftuar edhe përbërjen e trupit gjykues. Në datën 04.04.2024 kryetari i Gjykatës së Lartë ka pranuar kërkesën e një gjyqtari të trupit gjykues për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Në datën 08.04.2024, pas plotësimit të trupit gjykues, është bërë njoftimi me shpallje për shqyrtimin në dhomën e këshillimit në datën 16.04.2024, duke njoftuar edhe përbërjen e re të trupit gjykues. Njoftimi është dërguar edhe në adresën e postës elektronike të avokatit të kërkuesit S.D., i cili kishte nënshkruar rekursin.

37. Referuar dispozitave që rregullojnë rekursin në Gjykatën e Lartë, shqyrtimi në këtë gjykatë kalon në një ose në dy faza. Në fazën e parë, që njihet dhe si faza seleksionuese, neni 433 i KPP-së parashikon shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit, ku në mungesë të ekzistencës të të cilave Gjykata e Lartë disponon për mospranimin e tij, duke i dhënë kështu fund shqyrtimit. Edhe nga pikëpamja strukturore, neni 433 i KPP-së bën pjesë në seksionin e rregullave të përgjithshme që normojnë paraqitjen e rekursit (*shih vendimin nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se nuk rezulton që Gjykata e Lartë të mos ketë respektuar rregullat për publikimin e datave të shqyrtimit të rekurseve. Gjithashtu, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit ka cenuar të drejtat e tij kushtetuese, si dhe nuk ka ngritur ndonjë pretendim për përbërjen e trupit gjykues. Si rrjedhim, pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me atë për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

39. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura në rekurs dhe shtesat e rekursit. Në sekretarinë e Gjykatës së Lartë është depozituar një akt i titulluar shtesë rekursi dhe nuk është depozituar kundërrekurs sikundër shprehet në vendim Gjykata e Lartë, emërtimi si i tillë bërë nga Gjykata me qëllim rrëzimin e aktit. Gjykata e Lartë është kontradiktore për datën e formimit të KLP-së dhe emërimin e prokurorit të çështjes si anëtar të saj. Rekursi nuk duhej të pranohej, sepse nuk ishte bërë nga prokurori i çështjes. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, por shprehet se gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit të parashtruara në rekurs. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë për pretendimin se rekursi nuk ishte bërë nga prokurori i çështjes nuk është i qartë. Gjykata e Lartë nuk ka trajtuar në vendim të gjitha pretendimet e ngritura për pavlefshmërinë e akteve të hetimit, sikurse ka qenë edhe procesverbali për njohjen e akteve, të cilin kërkuesi nuk e ka nënshkruar, sepse nuk ka qenë prezent, ndërsa në procesverbal oficeri i Policisë Gjyqësore shprehet “refuzoi firmën”. Gjykata e Lartë ka shkelur ligjin kur shprehet se vendimi i gjykatës së apelit është i bazuar në ligj e në prova.

40. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim të drejtë, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 45, datë 03.10.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 19, datë 01.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 56, datë 25.07.2017; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme, pra të tilla që e bëjnë gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Në çështjen konkrete, sikur u trajtua më lart, në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë që ka deklaruar kërkuesin fajtor për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, gjykata e apelit e ka deklaruar fajtor atë për kryerjen e veprës penale të moskallëzimit të krimit (*shih paragrafët 3-4 të këtij vendimi*). Lidhur me përmbajtjen e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të kundërshtuar, në pjesën hyrëse të tij janë pasqyruar rrethanat e çështjes, duke përfshirë vendimmarrjet e gjykatave, si dhe shkaqet e parashtruara në rekursin e ushtruar nga kërkuesi në datën 14.11.2018 dhe nga Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda, në datën 14.12.2018. Në vendim është pasqyruar edhe fakti se në datën 21.12.2018 kërkuesi ka paraqitur aktin rekurs shtesë, për të cilin Gjykata e Lartë në vendim e ka cilësuar si kundërrekurs.

43. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursin e paraqitura si nga kërkuesi dhe prokuroria nuk përmbajnë asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar të gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të argumentuar dhe ka trajtuar pretendimet e të gjykuarit/kërkuesit të parashtruara në rekurs. Kolegji Penal ka arsyetuar se gjykata e apelit, në zbatim të nenit 152 të KPP-së, ka vlerësuar dhe analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra-tjetrën, duke mos paracaktuar dhe mbivlerësuar asnjë provë. Kolegji vë në dukje se gjykimi i kësaj çështjeje penale është zhvilluar

sipas procedurës së gjykimit të zakonshëm ku palët, nën parimin e kontradiktorietit, kanë paraqitur dhe kanë debatuar provat e lejuara nga gjykata dhe fuqinë provuese të tyre, duke mos mbivlerësuar asnjë provë. Kolegji Penal i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkuarit për mospranimin e rekursit, pasi nuk ishte paraqitur nga prokurori i çështjes, duke argumentuar se prej datës 11.12.2018 prokurori i çështjes ishte zgjedhur anëtar i KLP-së (*shih paragrafin 33 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar edhe pretendimet për pavlefshmërinë e akteve, të cilat janë trajtuar dhe analizuar gjatë gjykimit të gjykatave më të ulëta (*shih paragrafin 34 të vendimit nr. 00-2024-1059, datë 18.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

44. Për pretendimin e kërkuarit se ai ka paraqitur aktin rekurs shtesë, ndërkohë Gjykata e Lartë në vendim e ka cilësuar si kundërrekurs, të paraqitur përpara ndryshimeve të bëra në KPP me ligjin nr. 41/2021, datë 23.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, pasojë mosmarrjen në shqyrtim të tij, Kolegji vëren se pretendimet e parashtruara nga kërkuari në datën 21.12.2018 në aktin rekurs shtesë (mospranimi i rekursit për shkak të paraqitjes jo nga prokurori i apelit; për pavlefshmërinë e deklarimeve të pandehurit tjetër), Gjykata e Lartë i ka pasqyruar në vendimin e saj, si dhe ka arsyetuar se përse akti shtesë rekursi nuk mund të merrej në shqyrtim. Sikur u analizua, Gjykata e Lartë në përfundim ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura nga kërkuari, po ashtu edhe nga prokuroria.

45. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë alogjik dhe të ketë kundërthënie, ndërsa pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura në rekursin e kërkuarit, për rrjedhojë plotëson kërkesat për respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Analiza e tij nuk përmban gabime faktike dhe interpretimi i ligjit procedural nuk rezulton arbitrar. Për pasojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, është haptazi i pabazuar.

46. Në përfundim, Kolegji çmon se, bazuar në arsyetimin e mësipërm, kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a”, “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.